



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo



PROKURORIA THEMELORE GJILAN/
OSNOVNO TUŽILAŠTVO U GNJILANE/ BASIC PROSECUTION IN GJILAN



BULETINI I PROKURORISË THEMELORE NË GJILAN

Janar – Mars 2025

Përmes këtij buletini do të pasqyrohen aktivitetet kryesore, të cilat janë realizuar në Prokurorinë Themelore në Gjiilan, për periudhën kohore Janar-Mars 2025

Kryeprokurori Kadriu priti në takim përfaqësues të KFOR-it turk

Gji

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gji, z. Arben Kadriu ka pritur në takim përfaqësues të KFOR-it turk, major z. Yunus Yildiz dhe nënoficerin z. Faruk Karatas.

Gjatë këtij takimi, Kryeprokurori Kadriu, fillimisht falënderoi përfaqësuesit për vizitën dhe i njoftoi të njëjtit lidhur me funksionimin e Prokurorisë Themelore në Gji, kompetencat, organizimin dhe sfidat e punës së kësaj prokurorie.

Në anën tjetër, përfaqësuesit e KFOR-it turk, falënderuan kryeprokurorin për pritjen dhe bashkëpunimin e ofruar dhe theksuan se mbeten të përkushtuar në misionin e tyre.

Në fund të këtij takimi të njëjtit shprehën gatishmërinë e tyre për bashkëpunim të mëtutjeshëm me Prokurorinë Themelore në Gji, me qëllim të kontributit në sigurimin e paqes.



Ndalo

Gji

Prokuroria Themelore në Gji

Dyshohet se të njëjtit më datën 8 janar 2025, në rrugën "Metush Krasniqi", në Gji

Me këto veprime dyshohen të kenë kryer veprën e sipërshënuar penale dhe prokurori i rastit brenda afatit ligjor ndaj tyre do të kërkojë masën e paraburgimit nga Gjykata Themelore në Gji

PROKURORIA THEMELORE
GJILAN

Ndalo

10 janar 2025



24 persona të akuzuar brenda një jave nga Prokuroria Themelore në Gjiilan

Gjiilan, 13 janar 2025

Prokuroria Themelore në Gjiilan, gjatë javës së fundit, përkatësisht nga data 6 – 12 janar 2025, ka pranuar gjithsej pesëdhjetetë (58) kallëzime penale.

Gjithashtu, gjatë kësaj jave janë proceduar:

- njëzet (20) aktakuza, ndaj njëzetekatër (24) personave,
- njëzetekatër (24) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- tridhjetë (30) kërkesa të ndryshme drejtuar policisë,
- pesë (5) ankesa,
- pesë (5) persona të ndaluar,
- tri (3) kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit ndaj katër (4) personave.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj periudhe kohore janë intervistuar tridhjetegjashtë (36) persona.



Kryeprokurori Kadriu priti në takim përfaqësues të KFOR-it amerikan

Gji, 14 janar 2025

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gji, z. Arben Kadriu, së bashku me prokurorin nga Departamenti për Krime të Rënda z. Isuf Sadiku, kanë pritur në takim përfaqësues nga Zyra Ligjore e KFOR-it amerikan, kapitenin z. Ryan Adams dhe kapitenen znj. Laura Eckstein.

Në fillim të takimit kryeprokurori Kadriu dhe prokurori Sadiku falënderuan përfaqësuesit e KFOR-it amerikan për vizitën dhe i njoftuan të njëjtit lidhur me punën, organizimin, funksionimin dhe kompetencat e kësaj prokurorie.

Po ashtu, u vlerësua roli i tyre në ruajtjen e sigurisë, paqes dhe stabilitetit gjatë realizimit së detyrave të tyre dhe u pajtuan për bashkëpunim të mëtutjeshëm mes vete.



Kërkohet paraburgim ndaj një personi për vrasje në tentativë

Gjiilan, 14 janar 2025

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti për Krime të Rënda, ka kërkuar caktimin e masës së paraburgimit nga Gjykata Themelore në Gjiilan, ndaj të pandehurit E.H., për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale "Vrasja në tentativë", të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas kërkesës ekziston dyshimi i bazuar se më datën 13 nëntor 2024, në Gjiilan, i pandehuri E.H., ka tentuar ta privojë nga jeta të dëmtuarin L.H., në atë mënyrë që për shkak të mosmarrëveshjeve paraprake verbale, me thikë e godet të dëmtuarin një herë në pjesën e shpatullës së majtë, ku pasi ndërhyjnë dëshmitarët dhe e largojnë i njëjti ikën nga vendi i ngjarjes, ndërsa, i dëmtuari si pasojë e plagës së marrë fillimisht dërgohet në Emergjencën e Spitalit Regional në Gjiilan, pastaj për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore transferohet në QKUK.

I pandehuri E.H., që nga koha e kryerjes së kësaj vepre penale ka qenë në arrati.



Përmbledhje e punës javore

Gji

Prokuroria Themelore në Gji

Gjithashtu, gjatë kësaj jave janë proceduar:

- tetëmbëdhjetë (18) aktakuza, ndaj nëntëmbëdhjetë (19) personave,
- tetëmbëdhjetë (18) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko - ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- gjashtëdhjetëdy (62) kërkesa të ndryshme drejtuar policisë,
- pesë (5) persona të ndaluar,
- tri (3) kërkesa për sigurimin e të pandehurve në procedurë penale, ndaj tre (3) personave.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj periudhe kohore janë intervistuar njëzet (20) persona.



Prokuroria Themelore
Gji

Përmbledhje e punës javore

13 - 19 janar 2025

- 18 aktakuza
- 18 aktvendime
- 62 kërkesa policisë
- 63 kallëzime penale të regjistruara
- 5 persona të ndaluar
- 20 persona të intervistuar

Aktakuzë për vrasje të rëndë, armëmbajtje pa leje dhe dhënie të ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale

Gjiilan, 23 janar 2025

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë ndaj të pandehurve V.S. dhe F.M., të cilët gjenden në masën e paraburgimit që nga data 12 nëntor 2024.

Sipas aktakuzës, i pandehuri V.S., më 7 nëntor 2024, rreth orës 14h, në rrugën „Mërgimtarët e Gjiilanit”, në Gjiilan, me dashje, për shkak të një konflikti fizik të ndodhur para dy viteve, ka privuar nga jeta tani të ndjerin S.O., në atë mënyrë që derisa i ndjeri ishte duke hyrë në veturë, i afrohet dhe me armë e gjuan në pjesën e pasme të shpinës, ku pasi rrëzohet në tokë e godet me grusht dhe shqelm dhe më pas së bashku me të pandehurin F.M. janë larguar nga vendi i ngjarjes, ndërsa i ndjeri për shkak të plagëve të marra ka ndërruar jetë.

Me këto veprime, i pandehuri V.S., ka kryer veprën penale “Vrasja e rëndë”, nga neni 173 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjithashtu, i njëjti akuzohet edhe për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 të KPRK-së, pasi pa autorizim ka mbajtur në pronësi armë zjarri, e cila është sekuestruar.

I pandehuri F.M., që nga data 7 - 12 nëntor 2024, në vende të ndryshme në Gjiilan, me dashje ka ndihmuar të pandehurin V.S., në fshehjen - mos zbulimin e kryesit të veprës penale të vrasjes së rëndë, me çka ka kryer veprën penale “Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale”, nga neni 380 të KPRK-së.



Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gji

Kryetarin e Gjykatës Themelore në Gji

Policisë në Gji

Gji, 27 janar 2025

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gji, z. Arben Kadriu ka mbajtur takim me kryetarin e Gjykatës Themelore në Gji, z. Venhar Salihu dhe drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Policisë në Gji, z. Agron Rukiqi.

Në këtë takim ishin të pranishëm edhe zëvendës drejtori i Drejtorisë Rajonale të Gjilanit, z. Remzi Azemi dhe prokurori nga Departamenti për Krime të Rënda, z. Isuf Sadiku.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi rreth sigurisë në regjionin e Gjilanit, si dhe koordinimi dhe bashkëpunimi i këtyre institucioneve lidhur me procesin zgjedhor.

Të pranishmit u dakorduan që në bazë të kompetencave të tyre të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme eventuale, në rast të cenimit të procesit zgjedhor.



Prokuroria Themelore në Gjilan brenda javës ka ndaluar 8 persona

Gjilan, 27 janar 2025

Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë javës së fundit, përkatësisht nga data 20 - 26 janar 2025, ka regjistruar gjithsej pesëdhjetë (50) kallëzime penale, ndaj gjashtëdhjetenjë (61) personave.

Gjithashtu, gjatë kësaj jave janë proceduar:

- pesëmbëdhjetë (15) aktakuza, ndaj shtatëmbëdhjetë (17) personave,
- tridhjeteshtatë (37) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko - ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- 16 kërkesa QPS-së dhe ZMNV-së,
- dyzetepesë (45) kërkesa të ndryshme drejtuar policisë.

Nga prokurorët kujdestar gjatë kësaj periudhe kohore janë ndaluar tetë (8) persona, për vepra të ndryshme penale.



Prokuroria Themelore në Gjiilan gjatë vitit 2024 ka ngritur 316 aktakuza ndaj 360 personave për dhunë në familje

Gjiilan, 28 janar 2025

Prokuroria Themelore në Gjiilan, ju njofton se gjatë vitit 2024 ka pasur në punë gjithsej 2210 kallëzime penale, përfshirë Departamentin e Krimeve të Rënda, Departamentin e Përgjithshëm dhe Departamentin për të Mitur, ku ka zgjidhur gjithsej 2157 raste, ashtu që nga numri i përgjithshëm janë kryer 97% e lëndëve.

Gjatë vitit 2024 përmes procedurave alternative, duke përfshirë edhe urdhërat ndëshkimor janë zgjidhur 40.8% e rasteve.

Ndërsa, sa i përket veprave penale të dhunës në familje, gjatë vitit 2024 janë ngritur gjithsej 316 aktakuza kundër 360 personave.

Prokuroria Themelore në Gjiilan mbetet e përkushtuar që të trajtojë me seriozitet të gjitha veprat penale, duke ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore.



Prokuroria Themelore në Gjilan për një javë ka intervistuar 47 persona

Gjilan, 3 shkurt 2025

Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë javës së fundit, përkatësisht nga data 27 janar – 2 shkurt 2025, ka regjistruar gjithsej tridhjetekatër (34) kallëzime penale, ndaj pesëdhjetegjashtë (56) personave.

Gjithashtu, gjatë kësaj jave janë proceduar:

- tridhjetedy (32) aktakuza, ndaj tridhjetetre (33) personave,
- dyzetetetë (48) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- njëzet (20) kërkesa QPS-së dhe ZMNV-së,
- katër (4) persona të ndaluar,
- gjashtë (6) kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit, ndaj gjashtë (6) personave.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj periudhe kohore janë intervistuar dyzeteshtatë (47) persona.



NJOFTIM PËR MEDIA

Gji

Prokuroria Themelore në Gji

Me urdhër të prokurorit kujdestar rasti është inicuar si "Trafikimi me njerëz", nga neni 165 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Prokuroria Themelore në Gji në bashkëpunim me Policinë e Kosovës do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, në mënyrë që të identifikohet/en kryerësi/it e kësaj vepr



Ndalohet një person për punime të paautorizuara dhe përvetësime të monumenteve kulturore

Gjilan, 13 shkurt 2025

Prokuroria Themelore në Gjilan, në bashkëpunim me Institutin Arkeologjik të Kosovës, kanë identifikuar aktivitete të paautorizuara në vende arkeologjike dhe më datën 10 shkurt 2025 është autorizuar Njësia për hetimin e krimeve mjedisore në kuadër të Drejtorisë së Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda në Prishtinë, që të ndërmarrin veprime hetimore, në çështjen penale ndaj të pandehurit D.H., për shkak të dyshimit të veprës penale “Punimet e paautorizuara dhe përvetësimet e monumenteve kulturore” nga neni 355 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Ndërsa, sot më datën 13 shkurt 2025, me kërkesë të Prokurorisë Themelore në Gjilan, nga policia është realizuar urdhër kontroll në lokalin e tij në Gjilan, ku janë gjetur dhe sekuestruar mbi 200 artefakte arkeologjike, prej të cilave 80 monedha janë prej periudhës së sundimit romak, bizantin dhe mesjetar.

Me urdhër të prokurorit të shtetit është ndaluar i pandehuri D.H., në kohëzgjatje prej 48 orëve, pasi dyshohet se ka kryer aktivitete hulumtuese të paautorizuara në vende arkeologjike me pajisje detektuese.

I njëjti dyshohet për veprën e sipërhënuar penale pasi me veprimet e tij ka kryer gërmime apo hulumtime arkeologjike pa autorizimin e organit kompetent.




Aktakuzë ndaj dy personave për grabitje

Gji

Prokuroria Themelore në Gji

Sipas aktakuzës, të pandehurit A.I. dhe E.D., me datën 18 janar 2025, në Gji

Të pandehurit sipas kërkesës së Prokurorisë Themelore në Gji



Prokuroria Themelore në Gji

aktakuza për dhunë në familje

Gji, 14 shkurt 2025

Prokuroria Themelore në Gji, gjatë muajit janar 2025, ka pranuar nëntëmbëdhjetë (19) kallëzime penale, ndaj nëntëmbëdhjetë (19) personave, për veprën penale "Dhuna në familje", të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjatë kësaj periudhe kohore Prokuroria Themelore në Gji, Departamenti Përgjithshëm, ka ngritur njëmbëdhjetë (11) aktakuza, kundër njëmbëdhjetë (11) personave, për veprën penale "Dhuna në familje".

Ndërsa, nga Departamenti për të Mitur është paraqitur një (1) propozim për shqiptimin e masës edukative, ndaj një (1) personi të mitur, për këtë vepër penale.



42 persona të akuzuar brenda një jave nga Prokuroria Themelore në Gjiilan

Gjiilan, 24 shkurt 2025

Prokuroria Themelore në Gjiilan, gjatë javës së fundit, përkatësisht nga data 17 - 23 shkurt 2025, ka regjistruar gjithsej tridhjetekatër (34) kallëzime penale, ndaj tridhjetenëntë (39) personave.

Gjithashtu, gjatë kësaj jave janë proceduar:

- tridhjetetë (38) aktakuza, ndaj dyzetedy (42) personave,
- dyzetekatër (44) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko - ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- katër (4) marrëveshje për pranimin e fajësisë,
- njëmbëdhjetë (11) kërkesa QPS-së dhe ZMNV-së,
- shtatëdhjetekatër (74) kërkesa të ndryshme policisë,
- gjashtë (6) persona të ndaluar.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj periudhe kohore janë intervistuar tridhjetekatër (34) persona.



Kërkohet paraburgim ndaj një personi për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar

Gji

Prokuroria Themelore në Gji

Sipas kërkesës, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri S.S., më 12 nëntor 2020, në komunën e Parteshit, ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare, në atë mënyrë që duke përdorur vulën zyrtare të Republikës së Kosovës ka konfirmuar certifikatën e të qenit gjallë të gjendjes civile dhe të vendbanimit të tani të ndjerës D.S., edhe pse e njëjta ka qenë e vdekur, ku në këtë mënyrë ka mundësuar marrjen e pensionit të shtetit zviceran personit tjetër në vlerë prej 22.192 Fr.Zvicerane.

I njëjti me urdhër të prokurorit gjendet nën masën e ndalimit 48 orësh.



Kryeprokurori Kadriu vizitoi kampin Bondsteel

Gji

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gji

Kryeprokurori Kadriu dhe prokurori Sadiku u pritën nga përfaqësuesit e Zyrës Ligjore të KFOR-it amerikan, kapiteni z. Ryan Adams, kapitenja znj. Laura Eckstein dhe përfaqësues të tjerë.

Fillimisht kryeprokurori falënderoi të njëjtit për pritjen, pastaj u diskutuan çështje të ndryshme të punës dhe u vlerësua roli i tyre në ruajtjen e sigurisë, paqes dhe stabilitetit në vend.

Gjithashtu, u vlerësua edhe bashkëpunimi i deritanishëm dhe u dakorduan që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe më tutje.



Prokuroria Themelore në Gjiilan gjatë muajit shkurt ka ngritur 16 aktakuza për dhunë në familje

Gjiilan, 4 mars 2025

Prokuroria Themelore në Gjiilan, gjatë muajit shkurt 2025, nga Departamenti Përgjithshëm, ka ngritur gjashtëmbëdhjetë (16) aktakuza, kundër gjashtëmbëdhjetë (16) personave, për veprën penale "Dhuna në familje".

Ndërsa, nga Departamenti për të Mitur janë paraqitur katër (4) propozime për shqiptimin e masave edukative, ndaj katër (4) personave të mitur, për këtë vepër penale.



**PROKURORIA THEMELORE NË GJILAN GJATË MUAJIT SHKURT
KA NGRITUR 16 AKTAKUZA PËR DHUNË NË FAMILJE**

Ndalohet një person për shitblerje të narkotikëve

Gjilan, 7 mars 2025

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës – Njësitin DHTN në Gjilan, pas hetimeve disa mujore, me urdhër të prokurorit ka ndaluar të pandehurin V.M., për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Tek i njëjti, në komunën e Vitisë janë sekuestruar 11 paketime substancë e dyshuar narkotike, e llojit “Marihuanë”, me peshë prej 10 kg. 488 gr., 3 peshore dhe para në vlerë prej 1,630 euro.

Me vendim të prokurorit i pandehuri V.M., gjendet në masën e ndalimit 48 orësh dhe ndaj tij brenda afatit ligjor do të kërkohet masa e paraburgimit.



Prokuroria Themelore
Gjilan

**Ndalohet një person për shitblerje
të narkotikëve**

7 mars 2025



Përmbledhje e punës javore


Gji

Prokuroria Themelore në Gji

Gjithashtu, gjatë kësaj jave janë proceduar:

- tridhjetedy (32) aktakuza, ndaj tridhjetetë (38) personave,
- njëzetekatër (24) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- tetëdhjetenjë (81) kërkesa të ndryshme drejtuar policisë,
- shtatë (7) persona të ndaluar,
- katër (4) kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit, ndaj katër (4) personave.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj periudhe kohore janë intervistuar tridhjetepesë (35) persona.



Prokuroria Themelore në Gjiilan mban takim në kuadër të Strategjisë Kombëtare kundër Trafikimit me Njerëz në Kosovë 2022-2026

Gjiilan, 17 mars 2025

Prokuroria Themelore në Gjiilan, në kuadër të Strategjisë Kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovë 2022-2026, gjatë ditës së sotme ka mbajtur takim me akterët të cilët merren me rastet kundër trafikimit me njerëz dhe veprat penale kundër integritetit seksual.

Në këtë takim të organizuar nga Prokuroria Themelore në Gjiilan, pjesëmarrësit u pritën nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjiilan z. Arben Kadriu, prokurorja koordinatore për veprat penale kundër trafikimit me njerëz znj. Leonora Kadriu dhe prokurorja koordinatore për veprat penale kundër integritetit seksual znj. Rabije Jakupi.

Pjesëmarrës gjatë këtij takimi kanë qenë përfaqësues nga Policia e Kosovës, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, Qendra për Punë Sociale, Qendra e Shëndetit Mendor, Drejtoria e Arsimit, Shërbimi Sprovues i Kosovës, OJQ "Akti".

Gjatë takimit janë diskutuar çështjet e zbatimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz në Kosovë 2022-2026, bashkëpunimi dhe koordinimi në mes këtyre institucioneve, në ndërmarrjen e veprimeve dhe masave konkrete, me qëllim të identifikimit të sfidave dhe përmirësimit të gjendjes në parandalimin dhe luftimin efikas të trafikimit me njerëz dhe veprat penale kundër integritetit seksual.

Në fund të takimit të pranishmit vlerësuan bashkëpunimin e deritanishëm dhe u dakorduan që të realizojnë takime të rregullta koordinuese.



Ndalohet një person për detyrim

Gji

Prokuroria Themelore në Gji

Dyshohet se i njëjti që nga data 29 maj 2024, deri në momentin e arrestimit të tij, përmes kanosjes serioze, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror ka detyruar të dëmtuarin F.S., që ti jepte shuma të ndryshme të parave, ku bazuar në provat e siguruara gjatë hetimit dyshohet se ka përfituar rreth 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro nga i dëmtuari.

Me vendim të prokurorit i pandehuri D.S. gjendet nën masën e ndalimit 48 orësh dhe brenda afatit ligjor ndaj tij do të ushtrohet kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit.



Ndalohet një person për mundësim apo detyrim në prostitucion

Gjiilan, 27 mars 2025

Prokuroria Themelore në Gjiilan, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës - Njësitin e Hetimeve të Trafikimit me Qenie Njerëzore, përmes zbatimit të masave të fshehta ka ndaluar të dyshuarin M.M., për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale "Mundësimi apo detyrimi në prostitucion", nga neni 234 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Ekziston dyshimi se i dyshuari M.M., me qëllim të përfitimit material, duke ushtruar profesionin e taksistit, iu ka mundësuar vajzave të moshave të ndryshme që të merren me prostitucion, duke iu aranzhuar takime me persona të ndryshëm për shërbime seksuale, në këmbim të të hollave, ashtu që nga Prishtina i sjellë në Gjiilan dy vajza të moshës 22 dhe 23 vjeç, ku për shërbimet seksuale për të njëjtat i merr të hollat në shumë prej 520 euro, në bazë të masës së fshehtë të simulimit të rastit.

Me këto veprime dyshohet se i njëjti ka kryer veprën e sipërshënuar penale për të cilën me urdhër të prokurorit të shtetit gjendet nën masën e ndalimit 48 orësh.

